



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1130/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesuese, Milena Đerić dhe Adnan Konushevc, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, për thyerjen e heshtjes zgjedhore, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale, të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dhe Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 300.00 (treqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët-thyerja e heshtjes zgjedhore.

**II.** Detyrohet Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Pzap me datën 14.11.2021 ka pranuar ankesën me numër Anr.1130/2021, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se aktivistet e sajë nga Qendra në Prishtinë, kanë vërejtur se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në ditë e votimit-heshtjes zgjedhore në rrjetin social Facebook në faqën “Rinia me LDK-në” kanë shpërndare dhe sponsorizuar material zgjedhor fotografi të kandidatit për kryetar të Komunës z. Përparim Rama.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi ka bashkangjitur një fotografi, me te cilat i mbështet pretendimet e tije.

PZAP-i me datën 14.11.2021 e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 15.11.2021 në orën 10:00, të përgjigjet në ankesë.

Në përgjigjen në ankesë, Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, të datës 15.11.2021, kanë theksuar se e kundërshtojnë pretendimin e Subjektit Politik LVV, ngase nuk përfaqëson prova konkrete sepse nuk ka as date e as ore te postimit ne to nuk dihet se kur janë postuar madje nuk arrihet te provohet se faqja “Rinia me LDK-në” është e udhëhequr nga aktivistet e LDK-së, ngase faqe të tilla është e lehtë të hapen madje në rastin konkret edhe nga vete kundërshtaret e politik.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se aktivist të Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në Facebook në faqën “Rinia me LDK-në” kanë vazhduar postimin e fotove me përmbajtje elektorale ku shihet kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës Përparim Rama, gjat heshtjes zgjedhore veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, në të cilën përcaktohet se gjatë heshtjes zgjedhore është e ndaluara bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik të lartë cekur, në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Subjekti në fjalë, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Përveç të cekurave më lartë Paneli,

me rastin e vendosjes e vlerësoi të gjitha pretendimet e ankuesit, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, dhe të njëjtat ishin relevante dhe me ndikim për një vendimmarrje.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1130/2021 me datën 15.11.2021

**Kryesuese e Panelit**  
Ferki Xhaferi



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa komfor nenit 118 par 4 të LZP-së***